

VENDIM
Nr.451, datë 16.6.2010

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PRONËS NDËRTESE
DYKATËSHE, ME VENDNDODHJE PRANË AEROPORTIT “NËNË TEREZA”, RINAS,
NGA MINISTRIA E BRENDSHME TE MINISTRIA E FINANCIVE, PËR DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË DOGANAVE, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.524, DATË
15.8.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE, TË CILAT I KALOJNË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË FINANCIVE, PËR DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË DOGANAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës ndërtesë dykatëshe, me vendndodhje pranë aeroportit “Nënë Tereza”, Rinas, nga Ministria e Brendshme, (Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë) te Ministria e Financave, për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për ta përdorur si mjedis pune për degën doganore Rinas, sipas planimetrisë dhe formularit të inventarizimit të pronës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kjo pronë të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme, që i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme, që i bashkëlidhet vendimit nr.524, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave.

3. Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE


(për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror MRP (Drejtoria Policisë qarkut Tiranë)

Bashkia/Komuna Nikel

Fusha e përdorimit të pronës: Ruajtje rendi

Nr.rend	A			B			C			
	Zona kadas. Indeksi i hartës	Nr.pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip.totale e pronës (m ²)	Nga sip totale sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
										Ardhur me shkresën nr.4959/2 Dt.29.7.2002
10				Kondiniere metalik për zyra punë Rinas	78	78	Zyra	MRP	Dr.Pol.qarkut Tiranë	
11				Komisariati policisë "Rinas"	133	133	Zyra	MRP	Dr.Pol.qarkut Tiranë	



LEGEND:

- METALLIC GATE
- CONCRETE WALL
- DOG HOUSE
- PAVEMENT
- ASPHALT

	S.O.G of: RINAS	Drawing N° A/01
		Date:
	GEN-PLAN	Scale: 1:50

